



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1185 Prot.

Tiranë, më datë 03.12.2020

**VENDIM**  
**Nr. 453, datë 03.12.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.12.2020,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e raportit të sondazheve arkeologjike, ku shtrihet projekti zhvillimor: “Zona e re për zhvillim të Zonës 2 në Njësinë Administrative Durrës”, Bashkia Durrës, realizuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, “MEET ENGINEERING” sh.p.k., Taulant RAMA dhe Skënder MUÇAJ;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektet që do të zhvillohen “Zona e re për zhvillim të Zonës 2 në Njësinë Administrative Durrës”, Bashkia Durrës dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**

**Arta DOLLANI**

Arta  
Dollani

Digitally signed by  
Arta Dollani  
DN: c=AL, o=Instituti i  
Monumenteve të  
Kultures, title=Drejtor  
i Përgjithshëm,  
cn=Arta Dollani  
Date: 2020.12.03  
16:06:32 +01'00'

Elva  
Margarit  
i

Digitally signed  
by Elva Margariti  
Date: 2020.12.03  
16:58:37 +01'00'